



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:107730

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05726616

Rev.nr.82/24

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Zenel Leku dhe Muhamet Rexha, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditëses: Z. M., nga fshati B., Komuna e P., të cilën e përfaqëson Shefqet Gjevukaj avokat në P., sipas autorizimit, kundër të paditurës: “I. T.” L.L.C., Zyra Qendrore, në P., të cilën e përfaqëson Isamedin Dedinca, avokat në P., sipas autorizimit, për kompensim dëmi material, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.5320/21, të datës 07.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 21.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Pranohet revizioni i të paditurës: I. T.” L.L.C., Zyra Qendrore, në P., Prishen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.5320/21, i datës 07.12.2023, në pikën I, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr. 689/17, i datës 05.05.2021, në pikën I, II dhe IV, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

II. Mbetet i pashqyrtuar aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.5320/21, i datës 07.12.2023, në pikën II, të dispozitivit dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr. 689/17, i datës 05.05.2021, në pikën III, të dispozitivit.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.689/17, të datës 05.05.2021, është vendosur: I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Z. M. nga fshati B., Komuna e P., ashtu që: Detyrohet e paditura “I. T.” L.L.C., Zyra Qendrore

në P., që paditëses Z. M., nga fshati B., Komuna e P., në emër të kompensimit të dëmit material për vendosjen e kablllove optike në pjesën e ngastrës kadastrale nr. ... ZK B., t'ia paguaj shumat e specifikuara si më poshtë, dhe atë: kompensimin në emër të dëmit të shkaktuar gjatë punimeve, shumën prej 3.247,56 €, kompensimin në emër të humbjes së vlerës shumën prej 21.347,29 €, kompensimin në emër të kamatës për dëmin e shkaktuar gjatë punimeve, dhe vlerën e humbur në shumë prej 13.776,00 €. II. Detyrohet e paditura "I. T." L.L.C., Zyra Qendrore në P., që të kthej pjesën e paluajtshmerisë nr. ... ZK B., në gjendjen para vendosjes së kablllove optike, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. III. Refuzohet kërkesëpadia e paditëses Z. M., nga fshati B., Komuna e P., e cila ka kërkuar që të detyrohet e paditura "I. T." L.L.C, Zyra Qendrore në P., t'ia paguaj shumat e specifikuara si në vijim: në emër të qirasë vjetore (prej vitit 2013 deri në vitin 2019), shumën prej 9,240 €, në emër të kamatëvonesës për qiranë vjetore (prej 2013 deri në vitin 2019), shumën prej 739 €, në emër të kompensimit për kthimin e paluajtshmerisë nr.00014-0 ZK B., në gjendjen para vendosjes së kablllove optike shumën prej 3,000 €, si e pabazuar. IV. Detyrohet e paditura "I. T." L.L.C., Zyra Qendrore në P., që paditëses Z. M. nga fshati B., Komuna e P., për shumat e gjykuara si në pjesën e I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 38.370,85 €, me kamatë prej 8% në vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit më datë 29.04.2021, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 3,650 €, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin Ac.nr.5320/21, të datës 07.12.2023, ka vendosur: Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës "I. T." LL.C., me seli në P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.689/17, i datës 05.05.2021, në pikën I, II dhe IV, të dispozitivit të tij vërtetohet. II. Pika III, e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.689/17, i datës 05.05.2021, ngel e pa shqyrtuar.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion e paditura, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që revizioni i të paditurës të miratohet si i bazuar, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.5320/2021 i datës 07.12.2023, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore Pejë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.689/2017 i datës 05.05.2021, të ndryshohen ashtu që të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditëses si e pabazuar dhe të detyrohet paditësja që të paditurës t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësinë prej 2,908 €.

Përgjigje në revizion ka paraqitur paditësja, me të cilin e ka kontestuar revizionin e të paditurës, me propozim që të refuzohet revizioni në tërësi si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja më datë ..., ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensim dëmi material, duke kërkuar me saktësisht si në precizimin e kërkesëpadiës të datës 03.03.2020.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.689/17, të datës 05.05.2021, duke vendosur më decidivisht, si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se: për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike - kontestimore, ka administrua këto prova: certifikatën e pronës të datës ..., vërejtjen para ushtrimit të padisë drejtuar të paditurës të datës ..., përgjigjen e të paditurës të datës ..., aktvendimin e Komunës së P. - Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike, me nr., të datës 17.08.2012, orto fotot e pronës lëndore të datës ..., dhe procesverbalin e daljes në vend shikim të datës ..., ekspertizën e ekspertit gjeodet F. H. të datës 06.10.2017, bashkë me raportin me shkrim, kopjen e planit, skicën e matjes, orto - foton, certifikatën e pronës, ekspertizën e ekspertit gjyqësor Mr. M. H., ing. i elektros të datës ..., rregulloren për shërbimet komunale, mars ..., ekspertizën për vlerësimin e paluajtshmerisë, të ekspertit Sh. J. - vlerësues i pronave të paluajtshme, projekti i gropimit P. – B., të datës 24.05.2012, si dhe deklaratimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse.

Ka shtuar se, nuk ishte kontestuese fakti, se e paditura, në bazë të vendimit të organit shtetërorë, pra Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komunës së Pejës, ka pasur për obligim që t'i vendos kabllot optike vetëm për skaj rrugës së asfaltuar, drejtimi P. – K. – B.. Nuk ka qenë kontestuese as rrethana se ku janë vendosur - shtri kabllot optike për gjatë ngastrës kad.nr.... ZK B., në gjatësi prej 265,76 m, që është në pronësi private, respektivisht pronë e paditëses. Në këtë çështje juridike në mes palëve ishte kontestuese çështja se kërkesëpadija e paditëses, a ka apo nuk ka, bazë ligjor për kompensimin në emër të dëmit të shkaktuar, kompensimi i humbjes së vlerës së paluajtshmerisë, kompensimi për kthimin në gjendje të mëparshme, respektivisht largimin e kabllorëve nga prona e paditëses, si dhe kompensimi në emër të qirasë dhe kamatëvonesës.

Ka theksuar se bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike, duke u mbështetur në provat materiale, e sidomos duke u mbështetur në ekspertizat e eksperteve të lartcekur, gjykata vërtetojë se e paditura pa pëlqimin dhe pa marrëveshjen me paditësen, në mënyrë të kundërligjshëm ka shtrirë kabllot optike nëpër pronën e saj, dhe nga shfrytëzimi i pronës së saj, ka përfitime materiale, ndërsa paditëses i ka shkaktuar dëme, dhe ia ka humbur vlerën e paluajtshmerisë së saj, andaj, kjo gjykata e shkallës së parë menduar se kërkesëpadija e paditëses ka bazë ligjore. Duke u mbështetur në ekspertizat e ekspertit gjeodet dhe ekspertit të elektros, në mënyrë të pakontestueshëm është vërtetuar se e paditura, ka vendosur kabllon e internetit për afërsisht në mes të parcelës nr...., drejtimi jug - veri në gjatësi prej 265.76m, e cila evidentohet në emër të paditëses Z., edhe pse e paditura në bazë të vendimit të organit shtetëror ka pasur për obligim që të vendos kabllot optike, përgjatë brezit të rrugës së asfaltuar, që lidhë qytetin e P. dhe fshatin B. , e jo edhe në pronën e paditëses, andaj gjykata konsideron se paditëses duhet t'i kompensohet dëmi i shkaktuar material, si në piken I, të dispozitivit të këtij aktgjykimit. Paditësja me të drejtë thirret se e paditura në mënyrë arbitrare dhe të kundërligjshëm ka vendosur kabllot në pronën e

saj dhe gjykata duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit për vlerësimin e paluajtshmerive, konsideron se paditësja duhet të kompensohet në emër të dëmit të shkaktuar gjatë punimeve të gropimit, për vendosjen e kabllove fibër - optik, në emër të humbjes së vlerës së paluajtshmerisë (*duke llogaritur edhe kamatën*), më konkretisht sikurse në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për faktin se e paditura pa pëlqimin dhe pa marrëveshje me paditësen, në mënyrë të kundërligjshëm i ka shtrirë kablloptike nëpër pronën e saj, andaj e paditura detyrohet që të kthej pjesën e paluajtshmerisë me nr. ... ZK B., në gjendjen para vendosjes së kabllove optike. Lidhur me kërkesën e paditëses që të detyrohet e paditura të paguajë shumat e specifikuar sipas precizimit të kërkesëpadisë të datës ..., në emër të qirasë dhe kamatëvonesës (*prej vitin ... deri në vitin ...*), gjykata ka konsideruar se një kërkesë e tillë është e pabazuar, pasi që palët ndërgjyqëse nuk kanë pasur raporte kontraktuale dhe gjykata nuk mund ta detyron të paditurën që të kompensojë dëmin në emër të qirasë inekzistente, për çka edhe kërkesëpadia e paditëses mbi këtë bazë është refuzuar nga ana e gjykatës. Njëherit edhe kërkesa e paditëses që të detyrohet e paditura të paguajë shumën prej 3,000 €, në emër të kompensimit për kthimin e pjesës së paluajtshmerisë lëndore, në gjendjen para vendosjes së kabllove optike, për gjykatën është i pabazuar, pasi që këtë kërkesë e absorbon pika II, e dispozitivit të këtij aktgjykimi, ku gjykata e ka detyruar të paditurën, që të kthej pjesën e paluajtshmerisë me nr. ... ZK B., në gjendjen e mëparshme.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 194 dhe 202 të LMD-së, nenit 1 të Protokollit të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, nenit 46 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7, 143 dhe 319, të LPK-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 449 dhe 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e paditura ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.5320/21, të datës 07.12.2023, ka vendosur që ta refuzojë ankesën e të paditurës, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetojë, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar në pikën I, II dhe IV, të dispozitivit me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika n) të pretenduara nga pala ankuuese, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht dhe se drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike

nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi themelësinë e pjeshme të kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi themelësinë e pjeshme të kërkesëpadisë.

Përveç të cekurave nëse i referohemi dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, i njëjti është kontradiktor në vetvete në mënyrën si është formuluar, dhe nga i njëjti nuk mund të kuptohet se çka realisht gjykata ka vendosur, për cilën pjesë e ka aprovuar kërkesëpadinë dhe për cilën pjesë e ka refuzuar, dhe çka saktësisht e ka obliguar të paditurën.

Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Aktgjykimi i shkallës së parë është marrë edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragraf 1 të LPK-së, e lidhur me nenin 99, për arsye se: padia e datës ... dhe precizimi i padisë si në parashtrësën e datës ..., nuk përmban elementet që duhet të përmbajë çdo parashtrësë, në fakt kërkesa në padi është e paqartë dhe e pakuptueshme dhe se nuk është e specifikuar saktë kërkesa se çka kërkon paditësjë në këtë rast. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë, para se të vendosë në mënyrë meritore për kërkesëpadinë e paditëses është dashur që padinë e paditësit ta kthejë në korrigjim, në kuptim të nenit 99 dhe 102 e lidhur me nenin 2 paragraf 1 të LPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund ta pranojë përfundimin dhe qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, si të drejtë dhe të ligjshëm edhe për faktin se e njëjta nuk ka arritur të japë arsye lidhur me faktet vendimtare mbi themelësinë e pjeshme të kërkesëpadisë dhe atë:

Gjykata e shkallës së parë, në dispozitiv të aktgjykimit ka vendosur që e paditura të detyrohet ti paguaj kompensimin e dëmit lidhur me vendosjen e kablllove optike në paluajtshmërinë e paditëses, mirëpo e njëjta nuk ka sqaruar se pse ka ardhur te një përfundim i tillë, kujt i referohet ky dëm, a i referohet pronës së dëmtuar me rastin e hapjes së kanalit si të tillë apo fitimit të humbur, pra e njëjta nuk ka sqaruar saktë dhe qartë vendosjen se a kemi të bëjmë me kthim në gjendjen e mëparshme të pronës, apo kompensim të fitimit të humbur.

Gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kërkesën për humbjen e vlerës së pronës, duke e llogaritur humbjen si të ekzistonte, shpronësimi i pronës së paluajtshme apo sikur të ekzistonte ndonjë biznes (humbje të biznesit), por nuk ka sqaruar se ku mbështetet kjo kërkesë, dhe me cilat prova vërtetohet se ka ekzistuar ndonjë biznes, apo hapje të ndonjë biznesi, sepse prona kontestues ka qenë me kulturë - livadh dhe se nuk ka prova të ketë pasur ndonjë zhvillim të ndonjë biznesi. Në anë tjetër në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ka vendosur që të kthej pjesën e paluajtshmerisë nr. ... ZK B., në gjendjen para vendosjes së kablllove optike. Në këtë kontekst nëse gjykata e shkallës së parë vjen në përfundim se kemi humbje të vlerës së pronës së padëmtuar duhet shikuar që humbja e vlerë së pronës së padëmtuar a është e natyrës përkohshme apo e përhershme, e pastaj të vendos lidhur me kërkesëpadinë e paditëses.

Gjykata e shkallës së parë në dispozitiv të aktgjykimit e ka detyruar të paditurën që të kthej pjesën e paluajtshmerisë nr. ... ZK B., në gjendje para vendosjes së kablllove optike, por nuk ka sqaruar se a duhet të largohen kabllot optike, apo të kthehet sipërfaqja e pronës në gjendje të mëhershme gjë që nga dispozitivi nuk mund të kuptohet se çka gjykata ka vendosur realisht.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë edhe pse ka dal në vendshikim për të bërë identifikimin e saktë të parcelës kadastrale - kontestuese, nëpër të cilën janë vendosur kabllot optike nga e paditura, në të cilën paditësi ka kërkuar kthimin në gjendje të mëparshme të pronës kontestuese dhe kompensimin lidhur me dëmin e shkaktuar, gjykata nuk ka arritur që sipas përshkrimit të bërë nga paditësja, të identifikojë saktësisht se cila është parcela kadastrale apo pjesa e saj, në të cilën paditësja ka pretenduar se është dëmtuar nga e paditura më saktësisht si në kërkesën në padi dhe lidhur me paluajtshmërinë kontestuese, duke e përshkruar saktësisht shtrirjen gjeografike të saj, gjatësinë dhe gjerësinë, sa është sipërfaqja e saktë e paluajtshmerisë kontestuese dhe cila është gjendja faktike në teren lidhur më atë parcelë kadastrale, çfarë kulture ka prona nëpër të cilën janë vendosur kabllot optike nga e paditura, në momentin e vendosjes së kablllove optike, e paditura a e ka bërë kthimin e pronës në gjendjen e mëparshme, apo kanalet nëpër të cilat e ka bërë shtrirjen e kablllove i ka lënë të hapura, ekspertiza e ekspertit gjeodet është e mangët, jo e plotë madje edhe konfuze, fakte këto të domosdoshme për një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Përveç të cekurave gjykata e shkallës së parë nuk ka konstatuar se mbi cilën bazë e paditura ka bërë vendosjen e kablllove optike në pronën e paditëses, a ka poseduar leje për një veprim të tillë, nëse ka pasur leje, a ju ka përmbajtur në përpikëri vendimit - lejes, për shtrirjen e kablllove

(vendosja e kabllave optikë është bërë në segmentin e rrugës sipas vendimit - lejes, për shtrirjen e kabllave apo e paditura nuk këtë rast nuk ju ka përmbajtur vendimit-lejes së theksuar. Ky lëshim nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ka ndodhur për faktin se gjyqtari i çështjes nuk ka konstatuar gjendjen faktike në vend, nuk ka kërkuar korrigjimin dhe plotësimin e ekspertizës së ekspertit gjeodet sepse nëse i referohemi të njëjtës nga e njëjta rezultoni se nuk ka përshkrim të pronës, nuk ka të dhëna të sakta për parcelën kadastrale kontestuese si: nuk ka përshkrim të gjendjes faktike në vend - nuk ka të dhëna se objekt kontesti është parcela kontestuese apo pjesa e saj, nuk ka konstatuar se parcela kontestuese në momentin e shikimit në vend çfarë kulture ka detajisht - duke përshkruar pjesën e saj sipas kulturave në vend, cila është shtrirja gjeografike e saj, nëpër cilën pjesë saktë shtrihen kabllot të vendosura nga e paditura.

Nga se u tha me lartë gjykata e shkallës së parë nuk ka konstatuar cili është dëmi, i shkaktuar nga veprimet e të paditurës, kujt i referohet ky dëm, a i referohet pronës së dëmtuar me rastin e hapjes së kanalit si të tillë apo fitimit të humbur, pra e njëjta nuk ka sqaruar saktë dhe qartë vendosjen se a kemi të bëjmë me kthim në gjendjen e mëparshme të pronës, apo kompensim të fitimit të humbur, apo për humbjen e vlerës së pronës, të cilën e ka llogaritur humbjen si të ekzistonte ndonjë biznes (humbje të biznesit), por nuk ka sqaruar se ku mbështetet kjo kërkesë, dhe me cilat prova vërtetohet se ka ekzistuar ndonjë biznes, apo hapje të ndonjë biznesi, sepse prona kontestuese ka qenë me kulturë - livadh dhe se nuk ka prova të ketë pasur ndonjë zhvillim të ndonjë biznesi, ku përveç të cekurave gjykata nuk i ka vlerësuar provat në kuptim të pretendimeve dhe kundërshtimeve të palëve gjatë shqyrtimit kryesor dhe si rezultat i kësaj ka bërë shkelje të dispozitave të lartcekura të LPK-së, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që ti evitohet shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës, padinë e paditësit ta kthejë në korrigjim, në kuptim të nenit 99 dhe 102 e lidhur me nenin 2 paragraf 1 të LPK-së, sipas vërejtjeve të cituara me lartë dhe pastaj m' varësisht nga veprimi ose mosveprimi palës paditëse, gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të përgatitjes së shqyrtimit kryesorë, pastaj të caktoj shqyrtimin kryesorë dhe sipas propozimit të palëve, fillimisht të nxjerr prova në drejtim të vërtetimit të fakteve të theksuara më lartë, (cili është dëmi, i shkaktuar nga veprimet e të paditurës, kujt i referohet ky dëm, a i referohet pronës së dëmtuar me rastin e hapjes së kanalit si të tillë apo fitimit të humbur, a kemi të bëjmë me kthim në gjendjen e mëparshme të pronës, apo kompensim të fitimit të humbur, apo për humbjen e vlerës së pronës së padëmtuar, duke sqaruar se ku mbështetet kjo kërkesë, me cilat prova vërtetohet kjo kategori e kompensimit, se bashku me palët apo të autorizuarit e tyre dhe ekspertin gjeodet të dal në vend, ashtu që gjykata sipas përshkrimit të cilin do ta bëjë paditësja rreth paluajtshmerisë që pretendojnë të drejtën e kompensimit të dëmit, të udhëzojë ekspertin gjeodet që të bëjë identifikimin, incizimin dhe matjen e saktë të paluajtshmerisë/ve kontestuese. Pas identifikimit dhe matjes së saktë e cila do të bëhet nga eksperti gjeodet, gjykata do duhet ta bëjë përshkrimin e gjendjes faktike në vend dhe pastaj sipas mendimit-raportit me shkrim të cilin eksperti gjeodet do duhet t'ia sigurojë gjykatës, gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plot dhe të drejtë të gjendjes faktike, për të përcaktuar lartësinë e dëmit të pretenduar, për të përcaktuar vlerën e tokës varësisht nga kultura se e njëjta është me kulturë livadh etj, nëse

në mes të palëve është kontestues të caktoj ekspertizë (nga një apo grupi i eksperteve që duhet të jenë nga lëmia përkatëse), pastaj ti ftoj ekspertin/et, për të sqaruar dhe arsyetuar mendimin e dhënë në ekspertizë, dhe provave të propozuara nga palët, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ligjit (ligjeve) të cilat kanë qenë në fuqi në kohën kur pretendohet që janë krijuar raportet juridike në mes të palëve, të ketë mundësi që në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësoj rrethanat e çështjes lëndore e pastaj të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditëses dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitohet shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 224 paragrafi 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.82/24, datë 21.05.2024.

Kryetar i kolegjit
Rrustem Thaqi